



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 66

Datë: 13. 09. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, krye shef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr.62 dhe 63/2021.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi i listave votuese në spitale,

- Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për anëtar të KVV-ve për përbërjen e ekipeve mobile sipas komunave përkatëse, për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021,
- Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve dhe plotësimeve për anëtar të KVV-ve, për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021,
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Kryesuesit të KKZ-së në komunën e Dragashit,
- Asgjësimi i materialit zgjedhor,
- Rekomandim për ruajtjen e kutive të votimit të vendvotimeve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019, që kanë dallim në vota pas rinumërimit,
- Shqyrtimi dhe miratimi Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve.

5. Njoftim lidhur me përfundimin e mandatit të U.D të zv. Krye shefit Ekzekutiv të SKQZ-së.

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik.

7. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr.62 dhe 63/2021.

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 66-të të KQZ-së. Komisioni, është në përbërje të plotë, dhe agjendën e keni para vetës...

Arianit Elshani: Mendoj se, janë tre pikat të cilat realisht do të informonin më shumë opinionin publik, subjektet politike dhe organizata joqeveritare , e para është të dihet definitivisht çështja e vaksinimit dhe testeve pra të përcaktohet një rol mendoj se i takon Sekretariatit por të diskutohet te të ndryshme të ketë një rekomandim lidhur me se si do të bëhet verifikimi i atyre personave që i plotësojnë kriteret për të qenë anëtarë si komisionarë këtë rast brenda vendvotimit , e dyta është çështja e vëzhguesve të cilët duhet të informohen qoftë nga ju kryesues qoftë nga zyra për regjistrimin e partive politike pra lidhur me orën policore apo nga Sekretariati për shkak të orës policore që kanë dhe ne e dimë që dita e zgjedhjeve

pra do të kenë punë të mjaftueshme deri ne 2,3 të mëngjesit do të bëhet transportimi i gjithë atij materiali në QNR pra të lejohen lëvizja e lirë dhe tjetra ,pra këto dy janë kryesore dhe tjetra lidhur me shtetasit që kanë shtetësinë e Kosovës dhe të Maqedonisë të bëhet një njoftim qoftë nga Sekretariati qoftë nga ju lidhur me këta persona që posedojnë shtetësinë e Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë se Veriut

Kreshnik Radoniqi: Ndoshta, kishte me qenë mirë në këtë pjesën e parë, ndoshta Burimi do të jetë në gjendje në dy prej tyre dhe Ylli në njërin...! Dikush tjetër, a diçka lidhur me rendin e ditës ?

Nëse jo, kush është për këtë rend dite ?

Miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim, po ashtu miratohen procesverbalet nr. 62 dhe 63/2021.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Burim Ahmetaj: Para se të fillojmë me aktivitetet, më lejoni të përgjigjem në pyetjet që u shtruan nga zt.Elshani paraprakisht lidhur me disa kërkesa të cilat nevojiten edhe sqarime në lidhje me vaksinimin dhe testet që do të kërkohen për trupat zgjedhorë në ditën e zgjedhjeve është menaxheri i qendrës së votimit ai i cili është i obliguar që ti kontrollojë në hyrje të secilës qendër të votimit në mënyrë që tu lejohet qasja për të punuar si trupa zgjedhorë qoftë si komisionar apo, qoftë si staf teknik. Pra, kjo është detyra e cila, i caktohet menaxherit të qendrës së votimit të cilit do t'i lejohet qasja vetëm për të gjithë ata trupa zgjedhorë që i plotësojnë kriteret; Njëra nga 4 kriteret është edhe ajo që ka një dëshmi të vaksinës, e ka testin PCR 72 orë, apo testin Antigjen dhe dëshmitë tjera që mund ta ketë kaluar në 6 muajt e fundit covidin. Në bazë të këtyre edhe do të procesohet, mirëpo kjo nuk do të aplikohet për votuesit, kështu që nuk kemi ndonjë vendim që i ndalon votuesit për të hyrë në vendvotim për të votuar: kjo vlen vetëm për trupa zgjedhorë.

Në lidhje me qarkullimin e të gjithë trupave zgjedhor, këtu përfshihen edhe vëzhguesit të cilët do të vëzhgojnë gjithë procesin, nga tash e deri me certifikimin e rezultateve përfundimtare. Edhe KQZ, përmes mekanizmave të komunikimit ka komunikuar me policinë e shtetit të Kosovës dhe përmes dhomës operative, ku kemi komunikuar dhe kemi kërkuar leje për të gjithë trupat zgjedhorë të cilët posedojnë ID bexh të KQZ-së dhe të njëjtit, mund të qarkullojnë lirshëm . Kjo kërkesë, është miratuar nga dhoma operative e policisë së Kosovës. Pra, të gjithë personat që angazhohen ditën e zgjedhjeve dhe posedojnë ID bexh nga KQZ, qoftë si trupë zgjedhore, qoftë komisionar apo vëzhgues mund të qarkullojë lirshëm.

Këtu bën pjesë edhe vëzhguesit e akredituar, mediat e akredituara dhe të gjithë ata që posedojnë leje, ose janë të angazhuar në proces.

Ndërsa, tema të cilën e kemi diskutuar vazhdimisht këtu është që ka lidhje me dyshtetësinë! Të gjithë ata qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët, njëherësh kanë edhe shtetësinë e Republikës së Maqedonisë të Veriut dhe ditën e zgjedhjeve kur mbahen zgjedhjet në shtetin e Republikës së Kosovës në të njëjtën ditë do të mbahen zgjedhjet lokale edhe në Republikën e Maqedonisë, kemi marrë konfirmime nga Komisioni Shtetërorë i Maqedonisë së Veriut dhe identifikimi i të gjithë votuesve në ditën e zgjedhjeve do të bëhet sipas sistemit elektronik. Pra, nuk do të përdorin sprejin ultraviolet për tu identifikuar sikur që e përdorim në Republikën e Kosovës. Kjo u jep mundësi të gjithë votuesve të cilët kanë dy shtetësi që të votojnë në shtetin e Kosovës, duke respektuar procedurat me uvej sprej, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të identifikohen sipas identifikimit elektronik. Ajo çka është konfirmua nga Komisioni Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut është se në rast se kanë probleme teknike, atëherë do ta përdorim metodën tradicionale, mirëpo kjo mund të ndodhë.

Në vazhdim, ju informoj se është një rekomandim të cilin e shtrojmë para juve që kërkojmë të shqyrtohet dhe të merret vendim nga ana juaj që ti lejohet në secilin vendvotim për shkak të kushteve pandemike, për shkak të rrethanave, numrit të madh që mund të jenë në vendvotim ...Kemi rekomandimin që të lejohet vetëm një vëzhgues nga një subjekt politik në ditën e zgjedhjeve që, do të jenë të pranishëm në secilin vendvotim edhe të njëjtit, mund të ndërrohen vazhdimisht prej kërkesave të subjekteve politike. Mirëpo, prania duhet të jetë në të njëjtën kohë vetëm nga një subjekt politik. Ky, është rekomandim të cilin konsiderojmë që do të jetë konform edhe kushteve pandemike dhe kërkojmë shqyrtim dhe miratim nga KQZ.

Sa u përketë përgatitjeve, aktualisht jemi në periudhën e votimit jashtë Kosovës, periudhë e cila ka filluar me 15 shtator dhe do të përfundojë më datën 15 tetor. Deri me datën 12 tetor, KQZ ka pranuar gjithsej 3481 pako të supozuara me fletëvotime. Pakot janë marrë nga posta e Kosovës - nga qendra tranzitore e Kosovës dhe nga postat tjera siç janë DHL etj., prandaj, është me rëndësi se do të pranohen pakot e fletëvotimeve deri me datën 15 tetor, pra deri në orën 23:59. Aktivitet tjetër, është edhe regjistrimi i votuesve me nevoja te veçanta, aktivitet i cili është përmbyllur dhe është raportuar javën e kaluar. Mirëpo KQZ përkatësisht Sekretariati i ka rishikuar dhe vlerësuar të gjitha të dhënat dhe këto janë të dhënat finale pas verifikimit për të tri kategoritë. Sa i përket votimit të personave me nevoja të veçanta, në kategorinë e parë, votues me nevoja të veçanta janë rreth 1835 votues. Në kategorinë e dytë, votues në institucione

janë 1429 dhe në kategorinë e tretë votues me nevoja të veçanta, janë 28. Kështu, numri i votuesve për këto tri kategori, është 3292.

Më lejoni të ju njoftoj se, është përfunduar procesi i printimit të listave përfundimtare të votuesve dhe të njëjtat, kanë arritur në depon qendrore të KQZ –së. Po ashtu, më lejoni të ju njoftoj se ka filluar procesi i shtypjes së formularëve zgjedhorë të cilat janë në proces e sipër dhe të njëjtat do të pranohen në KQZ pra në depon e KQZ-së me datën 14 tetor dhe pastaj distribuomi i tyre nëpër komuna do të bëhet me 15 dhe 16 tetor pra jemi në proces e sipër për këtë qëllim kemi dërguar edhe ekipin e monitorimit për të shikuar të gjitha të dhënat para se të dërgohen në prodhim për tu siguruar që të gjitha të dhënat janë të sakta sikur që i ka miratuar KQZ dhe pas verifikimit atëherë do të lëshohen në prodhim pra për këtë qëllim e kemi dërguar edhe Komisionin i cili do ta monitorojë gjatë gjithë kohës procesin e printimit të formave zgjedhore po ashtu procesi i printimit të doracakëve dhe shpërndarjes së tyre është proces që tashmë në këto momente kur po raportojmë edhe është kompletuar dhe është shpërndarë te të gjitha komunat apo të gjitha KKZ-të dhe përmes tyre janë shpërndarë te komisionarët gjatë seancave të trajnimit.

Deri më tani, në depon qendrore të KQZ-së kanë arritur fletëvotimet, listat përfundimtare të votuesve, vulat për fletëvotime, materiale administrative për fletëvotime, kabinetat e votimit, alfabeti për votuesit e verbër - pra alfabeti brajlit, bateritë për uverllamba dhe uverllambat. Pra, këto janë materialet të cilat deri më tani i kemi në depon qendrore dhe të njëjtat, presim ti shpërndajmë nëpër secilën komunë, ndërsa në ditët në vazhdim pritet të arrijnë edhe këto materiale pra lidhëset e sigurisë, formularët zgjedhorë të cilët janë në proces të printimit, uversprej, ngjyra për vula dhe materiale tjera...

Sekretariati i KQZ-së, deri më tani ka shpërndarë në terren kabinetat dhe kutitë e votimit që janë shpërndarë në 34 komuna , janë furnizuar të gjitha komunat me material administrativ dhe materiale tjera si dhe shpërndarja e doracakëve në të gjitha komunat , ajo çka pritet të shpërndahet në ditët në vijim janë formularët zgjedhorë që do të shpërndahen të premtën me 15 tetor dhe materialet e ndjeshme sic janë fletëvotimet , vulat , lista votuese ,spreji, uverllambat dhe materialet tjera të shpërndahen me 16 tetor , më lejoni të ju njoftoj në lidhje me ekipet mobile pra është finalizuar numri dhe përbërja e ekipeve mobile që do të angazhohen në ditën e zgjedhjeve dhe për të gjithë votuesit me nevoja të veçanta dhe po ashtu me votuesit e infektuar me covid 19 për zgjedhjet lokale parashihen që të jenë 194 ekipe mobile ku prej tyre 109 mobile do të jenë në dispozicion të votuesve me nevoja të veçanta dhe 87 ekipe do të jenë në dispozicion për votuesit të cilët janë infektuar...

Tani, i kemi ndërtuar edhe ekipet mobile që do t'ju mundësojnë votimin përmes ekipeve mobile. Në anën tjetër, në këtë periudhë 26 ditore, pra nga data 16 shtator deri më 11 tetor, sipas raportimeve nga komisionet komunale të zgjedhjeve që i kemi deri më tani, janë paraqitur 896 kërkesa për tubime politike sipas rregullave të KQZ-së dhe masat mbrojtëse nga qeveria e Republikës së Kosovës pra masat anticovid, ndërsa sipas raporteve që i kemi deri më tani, pra deri me datën 11 tetor, 20 tubime politike janë mbajtur pa i përfillur rregullat zgjedhore dhe vendimin e qeverisë për masat mbrojtëse për covid 19. Kurse, 896 tubime tjera politike janë miratuar nga KKZ-ja dhe Policia. Prej tyre, 181 edhe pse janë lajmëruar nuk janë mbajtur fare...

Më lejoni të ju njoftoj po ashtu, edhe me aktivitetet e prokurimit të cilat kanë qenë javën e kaluar dhe në mbledhjet e kaluara të KQZ –së, dhe tani më lejoni për progresin e punëve në këtë aspekt. Sekretariati i KQZ – së, ka të zgjidhura deri më tani të gjitha kontratat e planifikuara për zgjedhjet lokale për furnizime dhe shërbime, të gjitha aktivitetet e prokurimit të cilat janë lidhur së fundmi janë aktiviteti i prokurimit për furnizim me forma zgjedhore, sprejin ultraviolet, id bexhat, doracakët e trajnimit dhe materiale e tjera.... Këto, janë kontratat e fundit të cilat janë nënshkruar nga Sekretariati i KQZ-së, ndërsa sa i përket aspektit të trajnimit të trupave zgjedhorë. Trajnimi në shumicën e komunave, ka filluar me datën 9 tetor dhe në vazhdimësi do të zgjasin deri me datën 15 tetor. Trajnimet që janë trajnimet për ekipet mobile dhe trajnimet e kryesuesve të komisionit komunal të zgjedhjeve, po ashtu ditën e shtunë do të bëhet trajnim plotësues për të gjithë ata që mungojnë ose mund të zëvendësohen. Pra, trajnimi i fundit që do të jetë trajnimi plotësues, do të mbahet ditën e shtunë me 16 tetor.

Ilir Gashi: Ajo që dëgjuam, pra gjithçka është duke shkuar sipas planit. Po shpresojmë që edhe të dielën, ashtu të vazhdojë të kemi një proces të rregullt dhe demokratik. Unë, do të ndalem te tri çështje edhe teknike por, edhe te rasti i votuesve që votojnë me dyshtetësi që votojnë edhe në Maqedoni. Këtu po thuhet se, ata votojnë përmes identifikimit elektronik por, në qoftë se atje nuk funksionon, atëherë do të duhet të përdoret metodologji e njëjtë si e përdorim edhe ne këtu. Unë po mendoj se duhet me pas një plan eventual që votuesve që janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe kanë edhe shtetësi të Maqedonisë të ju mundësohet në ditën e zgjedhjeve të votojnë. Nëse aplikohet metoda e njëjtë në të dy shtetet, do të thotë mos ta lëmë asnjë pa votuar...Te vëzhguesit, shpresoj, e para që bexhat e vëzhguesve të subjekteve politike të jenë sa më parë të prodhuar, dhe të jenë me kohë në mënyrë që edhe ata të jenë të gatshëm të përgatiten ti shpërndarje.

Sa i përket vëzhguesve në vendvotim, ne këtë e kemi diskutuar së paku dy herë dhe mendoj se duhet të kemi një vendim, dhe të mos ju lëmë kryesuesve të vendvotimit por qartë të themi se më shumë se një

vëzhgues (gjithmonë për shkak të pandemisë) subjektet politike mos ta kenë në vendvotim. Mundësinë e ndërrimit, ata e kanë sepse kanë vëzhgues rezervë, e përfshirë edhe organizatat, vëzhguesit sepse kështu mendoj se stërngarkohen klasët...

Sami Kurteshi: Faleminderit. I kam dy çështje për sqarim, e para është krejt teknike, në të vërtetë nga 900 tubime të lajmëruara, përveç atyre që nuk janë mbajtur janë lajmëruar, mesa dëgjova edhe nga raporti diku 20 tubime që nuk i kanë përfillë masat e përcaktuara nga IKSHP. A bën me ditë çfarë shkeljesh janë ato, sa serioze, a janë ndërmarrë veprime kundër subjekteve që i kanë shkelë këto masa dhe çfarë natyre janë ? Dhe çështja e dytë që dua ta ngris, është se edhe u përmend, janë dy lista të votimit! Ne si KQZ kemi kërkuar që ARC, një ditë, dy ditë para ditës së votimit na e dërgojnë listën plotësuese të personave që kanë heqë dorë nga shtetësia dhe të personave të vdekur...Për aq sa është e mundur të aktualizohet, a jeni në kontakt të përhershëm dhe, si do të veprohet...?

Arianit Elshani : Desha të e ngris çështjen e njëjtë që e tha z. Rama se në të vërtetë çështja e identifikimit në ditën e zgjedhjeve të gjithë atyre personave që do të marrin pjesë si trupa zgjedhorë si komisionarë , vëzhgues do të jetë vështirë për një menaxher të qendrës së votimit veçmas ato qendra të votimit që kanë një numër më të madh të vendvotimeve pra ndodhë që komisionarët edhe vonohen dhe pastaj për tu marrë me një rast individual pastaj edhe menaxheri i qendrës do të jetë vërtetë vështirë. Prandaj rekomandoj që këto çështja e identifikimit e këtyre personave të fillojë qysh nga sot nga ky moment qoftë me subjektet politike qoftë përmes KKZ-ve përmes Më e mira do të ishte përmes KKZ-ve, pra që të ftohen të gjithë ata persona të ofrojnë dëshmitë e tyre, ata të cilët janë vaksinuar dhe pastaj të tjerët të cilët do të kryejnë edhe testet mirëpo, edhe për ata që kanë qenë të infektuar gjatë 6 muajve të fundit, pra ashtu si e kemi marrë udhëzimin, dhe kjo do të fillojë qysh nga tash...

Florian Dushi: E para, sa u përket këtyre lejeve dhe unë mendoj që vërtetë duhet të kategorizohen edhe personat të cilët do të jenë të angazhuar gjatë kësaj periudhe duke filluar edhe me vetë institucionin tonë të KQZ i cili duhet të ketë tashmë leje të pakufizuar, Sekretariati po ashtu dhe trupat tjera të cilat megjithatë do të kenë punë vetëm në një periudhë të caktuar siç janë këshillat e vendvotimeve dhe vëzhguesit e cila mund të jetë një leje prej 48 orëve. Në anën tjetër, sa i përket çështjes së vaksinave unë mendoj që ndoshta do të jetë jashtëzakonisht e vështirë që në këto dy tri ditë subjektet politike të sigurojnë dëshmi të sjellin nëpër KKZ dhe KKZ-të pastaj, të njoftojnë menaxherin megjithatë mendoj që menaxherët e qendrave të votimit do të mund ta kryenin pa ndonjë problem këtë detyrë edhe për faktin se siç u tha, kanë të vërtetë qendra më të mëdha të votimit. E ne, kemi marrë një vendim që në qendrat e mëdha të votimit të kemi edhe nga një zëvendës menaxher, pra do të jenë dy përgjegjës që do të mund

të kryejnë këtë punë në ditën e zgjedhjeve, duke pas gjithmonë parasysh se në ditën e zgjedhjeve subjektet politike tashmë edhe me kohë kanë qenë të njoftuara se duhet të angazhojnë njerëz të cilët posedojnë njërën nga këto tri dëshmi. Konsideroj që kjo nuk do të paraqesë ndonjë problem sepse, pjesëmarrja e këtyre personave në këto trupa zgjedhorë apo në proces të monitorimit siç, është rasti me vëzhguesit, është në radhë të parë interes i subjekteve politike. Prandaj, konsideroj që ato kanë qenë mjaftueshëm të vëmendshme që me siguar personat të cilët posedojnë një nga këto 3 dëshmi, dhe nuk konsideroj që do të jetë ndonjë problem i madh që këta persona të dëshmojnë ditën e zgjedhjeve.

Burim Ahmetaj: Jam munduar me i mbledhë të gjitha ato që u biseduan dhe u kërkuan nga KQZ , nga anëtarët e KQZ-së , sa i përket ID bexhave tashmë e kemi kontratën dhe menaxherin e kontratës i cili, do ti shpërndajë bexhat sipas prioriteteve që në prioritet e kemi vëzhguesit që së pari ti shpërndajmë bexhat vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë pastaj kalojmë te shpërndarja e bexhave për trupat zgjedhorë dhe stafin tjetër të angazhuar kështu që jemi në proces e sipër ndërsa sa i përket pyetjes për tubimet për shkelje të masave anticovid sipas raportimeve që i kemi nga zyrtarët komunal të zgjedhjeve KKZ-ja praktikisht dhe nga policia e Kosovës.

Pothuajse të gjitha shkeljet kanë të bëjnë praktikisht me rregullat anticovid dhe për këtë policia e Kosovës ka identifikuar rastin sipas raporteve këtu e kemi raportin përmbledhës mirëpo, nëse ju nevojitet raport ne detaje do të mundohemi në takimet tjera të sjellim dhe në më detaje se për çfarë shkelje bëhet fjalë dhe për cilat subjekte bëhet fjalë. Ndërsa, sa i përket vaksinimit të trupave zgjedhorë kemi qenë shumë të vëmendshëm sidomos gjatë procesit të trajnimit që të kemi gjithë trupat zgjedhorë që i trajnojmë ti kemi të vaksinuar po ashtu KQZ ka dërguar vazhdimisht njoftime te subjektet politike që vetëm stafi që do të angazhohen si trupë zgjedhore do të mund të emërohen nga KQZ.

Deri më tani situatën e kemi shumë mirë në aspektin e 4 kriterëve që kërkohen mirëpo mund të na paraqiten problem zëvendësimet që mund ti kemi tash e tutje për shkak se komisionarët tërhiqen dhe mund të na vijë një komisionar tjetër kështu që na duhet të jemi shumë të vëmendshëm me këto zëvendësime që mund të bëhen në mënyrë që ta kenë njërën prej dëshmive sepse, nuk është vetëm dëshminë e vaksinës mirëpo janë edhe testet të cilët kanë dëshmuar në raste të ndryshme kanë dëshmuar me teste PCR ose antigjent apo dëshmi të tjera që e kanë kaluar covidin kështu që ne duhet të fokusohemi tash e tutje në mënyrë që të kemi plotësisht situatën në kontroll dhe të mos lejojmë asnjë trupë zgjedhore që nuk e ka njërën prej këtyre dëshmive që të punojë në ditën e zgjedhjeve ndërsa sa i përket kohës së kufizimit.

KQZ ka adresuar përmes mekanizmave dhe komunikimeve me policinë e Kosovës dhe kjo është mënyra që komunikojmë me policinë e Kosovës dhe përmes dhomës operative të policisë së Kosovës e kemi autorizimin që të gjitha trupat zgjedhore të kemi lirinë e qarkullimit mirëpo përpos trupave zgjedhore ne angazhojmë edhe staf tjetër teknik siç janë shoferët apo edhe stafi tjetër që praktikisht rekomandojnë që KQZ ti drejtohet Ministrisë së Punëve të brendshme që të hiqet për një kohë të caktuar për gjithë trupat zgjedhorë që angazhohen ditën e zgjedhjeve të hiqet kufizimi i orës policore dhe pastaj nëse vlerësojnë do të jetë vetëm për KQZ-në dhe Sekretariatit pasi që janë pas ditës së zgjedhjeve janë procese apo operacione që zhvillohen në një lokacion të lokalizuar kështu që ky është rekomandimi nga Sekretariati që të kërkojmë nga Ministria e Punëve të Brendshme që të hiqet plotësisht gjatë periudhës së zgjedhjeve ora policore për të gjithë qoftë këta që janë në garë po ashtu edhe për trupat zgjedhorë.

Ndërsa sa i përket raportit nga komuna sa i përket aspektit të trajnimit kemi mangësi tash nuk e di a është procesi i mos komunikimit mirëpo, nuk e kemi të detajuar raportin nga disa komuna të caktuara. Jemi duke bërë përpjekje që raportin kur të prezantojmë raportin final në KQZ ti kemi të gjithë raportet nga secila komunë në detaje sa staf janë trajnuar sa trupa zgjedhorë janë trajnuar , sa nuk kanë qenë të pranishëm se është më rëndësi shumë prania apo prezenca e tyre gjatë seancave të trajnimit.

KQZ ju ka dhënë mundësi komisionarëve në këtë rast anëtarëve të këshillave të vendotimit që në rast që nuk vijnë në seancën e caktuar të u jepet mundësia edhe një ditë tjetër të vijnë në trajnim përndryshe nëse nuk vijnë edhe herën e dytë atëherë duhet patjetër në këto raste të zëvendësohen dhe të plotësohen me anëtarë të këshillave ... Kështu, sa i përket raportit keni shumë të drejtë mirëpo, do të mundohemi që të kemi komunikimin në tërë territorin dhe jo vetëm në disa komuna të caktuara. Ndoshta, edhe një pikë tjetër që u theksua këtu edhe diskutua ka të bëjë me votuesit që kanë dy shtetësi kemi konfirmimin nga Komisioni Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut se në rastet kur dështon sistemi do të përdorin formën tradicionale që është e njëjtë, sikur procedura që e përdorim ne.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë ,e hedh në votim kush është për ?

Në mënyrë unanime, rekomandimi i Sekretariatit aprovohet.

Kreshnik Radoniqi: Sa i përket propozimit të z. Dushi, vetëm me i dërgua ndonjë shkresë qeverisë... Supozoj se të gjithë po pajtohemi që me ju drejtuar qeverisë me një kërkesë që me e pezullua orën policore për 48 orëMirë atëherë do ta bëjmë një kërkesë zyrtare qeverise ,Sekretariati ndoshta e

përpilon shkresën brenda ditës së sotme ... vazhdojmë me pikën e radhës aktivitetet e zyrës, z. Buleshkaj kur jeni i gatshëm ?

3.Aktivitetet e ZRPPC-së:

Ylli Buleshkaj: Para jush e keni një raport shumë të shkurtër lidhur me aktivitetet që mund të jenë relevante që të njoftoheni çka ka ndodhur në kohën mes dy mbledhjeve e që, është e rëndësishme. Besoj, shumë shpejtë do t'i pranojmë raportet e auditimit të financave të partive politike që do të na mundësojë neve si zyre shqyrtimi i tyre, dhe propozimi i rekomandimeve gjegjëse sipas legjislacionit në fuqi. Ajo çka është identifikuar nga kontraktori, është se mungojnë në listën e subjekteve politike që është dashur të auditohen. Tri parti politike, me gjasë për shkak të gabimeve teknike (emrat e partive politike i keni ashtu si edhe vitet) që është dashur të auditohen, për një arsye nuk janë futur në listën e subjekteve që është dashur të auditohen. Kërkesa ka shkuar ne kuvend dhe po besoj që shpejtë ishte dashur të marrim një përgjigje nga Kuvendi dhe nga zyra e sekretarit të Kuvendit.

Tjetra çështje, është puna e vëzhguesve pas përfundimit të akreditimit të vëzhguesve. I kemi pastruar të gjitha listat dhe, i kemi bërë gati të gjitha materialet që janë të nevojshme dhe të dhënat për ti shtypur këto distinktivë apo Id kartelat e vëzhguesve. Kemi filluar të pranojmë Id kartelat. Sot, kemi bërë shpërndarjen e të parave me prioritet, kemi filluar me organizata që kanë aplikuar në fillim edhe ato që kanë pasur vëzhgues afatgjatë që në shumicën kanë qenë organizata ndërkombëtare. Po ashtu, pritet që brenda ditës së nesërme të gjitha të përfundohen dhe të shpërndahen! Po presim, sot mund të kryhen të gjitha, pastaj me radhë partitë politike, organizatat dhe mediat të njoftohen që mund ti pranojnë. Pas pranimit të kartelave, ne e bëjmë edhe një verifikim të përgjithshme se, a janë kartelat sipas listave që i kemi dërguar. Po ashtu, jemi në përgatitje të programit për vëzhguesit e huaj, për mysafirët e KQZ-së që i ka ftuar për vëzhgim të zgjedhjeve...

Arianit Elshani: Kam dy çështje: e para lidhur me mos përfshirjen e këtyre subjekteve politike në auditim. Lista është marrë nga ne apo është marrë nga KQZ, apo kuvendi i Kosovës lidhur me auditimin e këtyre subjekteve, pra meqë po thuhet se është një lëshim i mundshëm i kuvendit dhe tjetra lidhur me aktivitetet zgjedhore të zgjedhjet lokale 2021. Thuhet se i gjithë entiteti së bashku me distinktivë, pranon edhe një numër të fletushkave dhe të këshilla relevante për vëzhguesit e tyre. Ne, po ashtu, kemi rënë dakord në Këshillin për Operacione Zgjedhore që fletushkat të shpërndahen brenda vendotimeve për shkak se

vëzhguesit aty, duhet ta kenë në vendvotim fletushkën dhe të dinë kompetencat dhe detyrat që i kanë ditën e zgjedhjeve, vetëm këtu një sqarim...

Sami Kurteshi: Unë, kam një pyetje konkrete: A ka ndonjë rekomandim apo ndonjë datë se kur do t'iu ofrohen raportet e audituara, këto që janë audituar deri më tani...?

Ylli Buleshkaj: Lista e partive politike si tërësi, është dërguar nga ne. Kuvendi i Kosovës i ka hequr disa subjekte politike nga lista. Fillimisht, i ka larguar ato të cilat nuk përfitojnë fonde nga fondet publike, e me gjasë këtu ka ndodhur problemi: janë larguar disa të cilat përfitojnë nga fondet publike. Për sa u përket fletushkave dhe shpërndarjes së tyre, ashtu siç jemi marrë vesh zyra e ka përgatitë një si formë plani të shpërndarjes, e ku nga 30.000 fletushka 29.000 shpërndahen nëpër qendra të votimit, ndërsa 1000 si exemplarë të cilat partitë mund ti përdorin gjatë trajnimeve të mundshme për vëzhgues..

Besoj, shpejtë pritet në fillim të muajit sipas informatave të para por tash është faza finale vetëm pritet përgjigjja nga kuvendi se, a do të auditohen edhe këto tri parti përndryshe, raportet janë finale dhe janë të përfunduara. Menjëherë pasi që t'i pranon kuvendi, i ri sjell te ne dhe ne, brenda ditësh i publikojmë...

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi i listave votuese në spitale:

Arianit Elshani: KOZ, ka shqyrtuar kërkesën e Sekretariatit për miratimin pra të regjistrit të votuesve me nevoja të veçanta që në ditën e zgjedhjeve me datë 17 tetor 2021, do të jenë pjesë në institucionin e kujdesit shëndetësor. Ne, sipas vendimeve paraprake në KOZ dhe KQZ, i kam caktuar disa data të tjera për identifikimin e këtyre votuesve, mirëpo për shkak të rrethanave të pandemisë covid 19 dhe për faktin që njerëz të tjerë të hospitalizohen në institucionet shëndetësore, është kërkuar që afati për regjistrimin e të gjithë këtyre personave të hospitalizuar, të jetë deri të premtën deri në ora 16 :00.

Pra, të na informojnë secili institucion shëndetësor, qofshin ato private qofshin ato publike që kanë pacientë të hospitalizuar të informojnë KQZ-në në mënyrë që ne të administrojmë në ditën e votimit tu mundësohet secilit qytetar pavarësisht së është i hospitalizuar të votojë përmes ekipeve mobile. Kjo, është kërkesa dhe rekomandimi i KOZ që ky afat të zhvendoset deri në ora 16 :00 për të premtën, edhe pse si KQZ do të jetë pak më vështirë e menaxhueshme, meqenëse duhet të shpërndahen edhe fletëvotimet e

komunave tjera pra zonave të tjera zgjedhore e në komuna përkatëse. Në këtë rast, do të jetë një barrë shtesë për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj: të gjitha ato vende që kanë spitale rajonale, pra do të jetë një barrë shtesë për këto KKZ-të prandaj rekomandojmë që të aprovohet kjo kërkesë dhe të zgjatet ky afat i identifikimi të gjithë atyre personave që janë të hospitalizuar...

Kreshnik Radoniqi : A ka dikush diçka ? Atëherë e hedh në votim , kush është për ?

Me 10 vota për miratohet rekomandimi

2.Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për anëtar të KVV-ve për përbërjen e ekipeve mobile sipas komunave përkatëse, për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021:

Arianit Elshani: KOZ, ka shqyrtuar edhe kërkesën e Sekretariatit për rekomandimin për nominimet për anëtarë të këshillave të vendvotimit për përbërjen e ekipeve mobile sipas komunave përkatëse për ditën e zgjedhjeve. Ju, keni një tabelë para vetes besoj në qoftë se Sekretariati ka arritur ta shpërndajë te të gjithë lidhur me përbërjen e ekipeve mobile sipas komunave përkatëse, e meqenëse kemi dy kategori të ekipeve mobile do të jenë ato ekipe mobile që do të shkojnë te personat e infektuar me covid, dhe në anën tjetër ekipe mobile që do të shkojnë te institucionet e trajtimit: qoftë te institucionet e paraburgimit, në burgje dhe ata të cilët janë lajmëruar po ashtu si të ngujuar apo me nevoja të veçanta duhet të votojnë nga shtëpitë e tyre. Pra, ky është numri i përgjithshëm i atyre ekipeve ku do të jenë në secilën komunë: 194 janë në total, 109 janë vetëm për kategorinë e parë, dhe për Covid 19, janë 87 ekipe mobile të shpërndara në tërë Kosovën për t'i mundësuar secilit qytetar të votojë ditën e zgjedhjeve...

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ?

Atëherë e hedh në votim, kush është për miratimin e kësaj pike ? Me 10 vota për miratohet përbërja e ekipeve mobile për zgjedhjet lokale të 17 tetorit.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve dhe plotësimeve për anëtar të KVV-ve, për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021:

Arianit Elshani: KOZ, ka shqyrtuar edhe kërkesën për zëvendësimin dhe plotësimin për anëtarë të këshillave të vendvotimit (KVV) për ditën e zgjedhjeve kemi për shkak të covid 19 dhe për shkak të

verifikimit që kanë bërë edhe subjektet politike mirëpo edhe për shkak që disa anëtarë pra komisionarë janë tërhequr nga detyra për të cilën, janë thirrur në fillim që të jenë prezentë në qendra të votimit në ditën e zgjedhjeve është kërkuar edhe nga subjektet politike që njëjtit të zëvendësohen. Mirëpo, po ashtu dhe për shkak se disa subjekte politike nuk kanë dërguar të gjitha plotësimet për anëtarë të këshillave të vendvotimit. Ne, sot kemi para vetes një rekomandim të ardhur nga secili komision komunal i zgjedhjeve pra i secilës komunë na kanë informuar për zëvendësimet dhe për plotësimet që kanë nevojë. Numri total i tyre është 818. Është kërkesa që këto zëvendësime dhe plotësime të aprovohen në KQZ, të njëjtit janë verifikuar edhe nga Sekretariati, në qoftë se këta komisionarë janë në listën votuese të asaj komune..

Kështu, ne si KOZ rekomandojmë që të aprovohen zëvendësimet dhe plotësimet për anëtar të KVV-e...

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ? Atëherë, e hedh në votim ? Kush është për miratimin e këtij rekomandimi ?

Me 10 vota për miratohet rekomandimi për zëvendësimin dhe plotësimin e anëtarëve të KVV-e...

Arianit Elshani : KOZ ka shqyrtuar edhe pjesën e zyrës së terrenit që vendimmarrja për zëvendësimin e këshillave të vendvotimeve pra të komisionarëve të autorizohen të gjitha komisionet komunale zgjedhore që këto zëvendësime ti kryen vetë deri të shtunën kur të informojnë edhe KQZ-në për këto zëvendësime kjo për të lehtësuar punën e tyre mirëpo edhe tjetra që të mos jenë gjatë tërë kohës të varur nga vendimmarrja në KQZ deri në ditën e zgjedhjeve për shkak se ata çdo ditë pra ballafaqohen në terren me këto kërkesa të subjekteve politike dhe të komisionarëve të cilët tërhiqen nga kjo detyrë apo për ata të cilët nuk marrin pjesë në trajnimet që mbahen nga komisionet komunale dhe kjo është arsyeja pse kërkohet që të autorizohen këto komisione komunale të zgjedhjeve që të kryejnë këtë detyrë sa më shpejtë , tjetra është se KKZ-të do të na informojnë neve deri të shtunën në ora 10 me raportet e zëvendësimit njëherit vendimmarrja e tyre do të jetë ...konsensuale në mënyrë që të mos dëmtojnë njërin apo tjetrin subjekt politik që ka nevojë për ti zëvendësuar komisionarët prandaj rekomandojmë që të aprovohet

Kreshnik Radoniqi : A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ? Atëherë e hedh në votim kush është për miratimin e këtij rekomandimi ?

Me 10 vota për miratohet rekomandimi për autorizimin e KKZ-ve për vendimmarrje lidhur me zëvendësimin e këshillave të vendvotimit

4.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Kryesuesit të KKZ-së në komunën e Dragashit:

Arianit Elshani: Sekretariati, i ka rekomanduar KOZ-it emërimin e ushtruesve të detyrës të zyrtarit të lartë të komisioni komunal të zgjedhjeve në komunën e Dragashit, apo konkretisht kryesuesin e KKZ-së për shkak të një aksidenti që i ka ndodhur z. Feisal Xhabali të cili, duhet ti urojmë një shërim sa më të shpejtë i cili po trajtohet aktualisht në QKUK. Pra, patjetër duhet të marrim një vendim lidhur me zëvendësimin e kryesuesit për këtë periudhë sa është në trajtim z. Feisal. Rekomandojmë që z. Haxhi Berisha, të zëvendësojë për këtë periudhë deri në shërimin e tij të plotë...

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ? Urdhëro z. Kurteshi...?

Sami Kurteshi: Unë mendoj se duhet me pas kujdes në kufizimin e kohës deri sa të shërohet se nuk dua të paragjykoj asgjë por, mendoj se duhet me pas një kufizim: me i parapri të gjitha situatave. Mund të jetë kryesues, sidomos në këtë fazë e domosdoshme por jo në mënyrë të pakufizuar, pajtohem deri kur është fundi i nëntorit...

Arianit Elshani: Kërkoj nga Sekretariati që të rregullojë si duhet këtë rekomandim, dhe vendimin që të mos jetë s'i u.d., se ashtu edhe u dakorduar në KOZ, por si kryesues i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve që nënkupton se ka një mandat të përkohshëm, deri në shpërbërjen e plotë të KKZ-së.

Florian Dushi: Në fakt nuk mundet me qenë kryesues pa qenë zyrtar sepse, fakti që ai është zyrtar e bën të jetë kryesues prandaj, unë mendoj se duhet me e emërua zyrtar komunal të zgjedhjeve që nënkupton me automatizëm është edhe kryesues i komisionit komunal i zgjedhjeve. Teknike është kjo...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit z. Dushi për sqarim. Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, e hedhë në votim. Kush është për miratim ? Me 10 vota për, nuk po e di Rifati a nuk donë më u kthye në mbledhje apo çka është puna, miratohet ky rekomandim emërimi: fillimisht të zyrtarit të KKZ-së, e pastaj si kryesues i KKZ-së...

5.Asgjësimi i materialit zgjedhor:

Arianit Elshani: KOZ, ka shqyrtuar kërkesën e Sekretariatit për ruajtjen e kutive të votimit të vendvotimeve të zgjedhjeve të parakohshme për kuvendin e Kosovës 2019 që kanë dallim me vota pas rinumërimit po shkruan në rend dite por gjatë KOZ me duket që raportuan për 2021tën pra për 2021tën është një lëshim

teknik në rendin e ditës bëhet fjalë për kutitë e vitit 2021 dhe këto kuti që do të ruhen pra datojnë që nga viti 2013 , 2017 , 2021 ,2012, 2014 që në total janë rreth 1500 kuti të cilat aktualisht disa prej të cilave janë në procese gjyqësore dhe 418 të cilat tashmë janë iniciuar do të iniciohen nga KQZ-ja dhe nga Sekretariati për shkak se kanë mospërputhje e që është bërë një vlerësim i përgjithshëm i këtyre vendotimeve dhe ka ndoshta mospërputhje të qëllimshme pra ndoshta dikush ka prekur ato kuti të votave dhe gjitha këto pra disa janë aktualisht në hetim dhe të tjerat që do të shkojnë në hetim pra ky është rekomandimi që të gjitha këto kuti të ruhen në QNR dhe në depon që e kanë

Kreshnik Radoniqi : Faleminderit z. Elshani a ka dikush diçka me këtë pikë ? Atëherë e hedh në votim kush është për miratimin e këtij rekomandimi ?

Me 10 vota për miratohet rekomandimi për ruajtjen e kutive të votimit të zgjedhjeve të përkohshme për kuvendin e Kosovës 2021

6.Rekomandim për ruajtjen e kutive të votimit të vendotimeve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019, që kanë dallim në vota pas rinumërimit:

Arianit Elshani : Po ashtu, Këshilli për Operacione Zgjedhore ka shqyrtuar , ne kemi shqyrtuar një vendim një rekomandim i cili ka ardhur për asgjësim, shkatërrim dhe për ruajtje të vendotimeve mirëpo e kemi ndarë në dy vendotime për shkak që të konfuzitetit që do krijojnë në një vendim ky është vendimi për të cilin realisht kemi diskutuar më së shumti për të marrë informata në hollësi në qoftë se të gjitha procedurat kanë përfunduar në qoftë se këto vendotime kanë një aktgjykim të plotfuqishëm, prandaj është rekomanduar që të asgjësohen vendotime e vitit të zgjedhjeve 2010 zgjedhjet nacionale ato të 2011 - tës dhe 2021- it për të cilat kanë përfunduar të gjitha hetimet për të cilat ka vendime të formës së prerë. Pra, bëhet fjalë për rreth 2500 kuti të votimi të cilat do të asgjësohen dhe do të lirohet një hapësirë e madhe e QNR-së për të punuar në ato hapësira e po ashtu, nga këto materiale nga këto kuti të votimit do të ruhen pakot e votimit me material të papërdorur zgjedhor në mënyrë që ato të përdoren të njëjtat për trajnim e do të ruhen vulat zyrtare të fletëvotimeve, pjesa e drurit dhe dosjet e formularëve të rezultateve të paplotësuara dhe zarfet e bardha të fletëvotimeve dhe zarfet e fshehtësisë. Ky, është rekomandimi i KOZ-it që të asgjësohen rreth 2500 kuti për të cilat ne kemi marrë rekomandimet nga të gjitha institucionet

Sami Kurteshi: Veç e kam për sqarim: A do të asgjësohen kutitë se kutitë e votimit, apo vetëm materiali në to, se ato kutitë na duhen, a po ?

Kreshnik Radoniqi: Okej, është fjala për fletëvotimet e zgjedhjeve të kaluara edhe zbrazja e kutive të votimit , a ka dikush diçka lidhur me këtë , atëherë kush është për miratimin e këtij rekomandimi ?

Atëherë, me vota unanime miratohet rekomandimi për asgjësimin e materialit zgjedhor të vitit 2010 , 2011 dhe 2021 që përbëjnë rreth 2500 kuti votimi do të thotë materiali brenda në kuti ndërsa kutitë mbesin.

7. Shqyrtimi dhe miratimi Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve:

Arianit Elshani KOZ, ka shqyrtuar edhe planin operacional për ditën e zgjedhjeve. Besoj se, secili e keni para vetes. Për shkak të ndryshimeve, ne e mbajtëm mbledhjen e përfunduar pak kohe, para se të fillojë kjo mbledhje pra rreth 15 minuta, para se të fillojë kjo mbledhje e KQZ-së dhe ne përfunduar mbledhjen e KOZ-it. Ne me konsensus e kemi përfunduar, por nuk ka kuptim që të tjerët që nuk janë pjesë e KOZ-it të miratojnë një plan që nuk e kanë shqyrtuar. Pra, ky plan operacional ka të bëjë me ditën e zgjedhjeve. Janë detajuar të gjitha çështjet, cilat aktivitetet do ti zhvillojmë etj. Ne KQZ në ditën e zgjedhjeve, qoftë në aspekt të dhomës operative, qoftë të vëzhgimit dhe monitorimit të zgjedhjeve të KKZ -ve si po shkon puna në secilën komunë, pra do të ketë ekipe të cilat do të merren me monitorim: ku do të jenë zyrtarët tanë të Sekretariatit që do të kryejnë këtë punë dhe pastaj, edhe zyrtarë tjerë që do të jenë të angazhuar në ditën e zgjedhjeve; Dhe për çështjet edhe protokollare, edhe në raport me mediat dhe me të gjitha aktivitetet që i zhvillojmë. Po ashtu, është edhe plani i konferencave për media i KQZ-së që në të kaluarën, dikush ka menduar se mbajmë aktivitet ceremonial në ditën e zgjedhjeve.

Realisht, kemi kërkuar që të mbahen mbledhje të KQZ-së, pra të jetë organizuar me afate kohor, ta di secili medium paraprakisht për orarin e mbajtjes të atyre etj. Mirëpo, të jetë një mundësi edhe për të shprehur secili anëtar, pra çështjet të cilat evidentohen gjatë ditës së votimit; qoftë parregullsi, qoftë të aspekteve informative në raport me hamendësimet që mund ti kenë votuesit apo subjektet politike në ditën e zgjedhjeve; pra të mbahen mbledhjet të caktuara me kohë dhe të informohet publiku me kohë për ato mbledhje pra siç është zakoni në ora 8:00 zëdhënësi do të informojë për hapjen e qendrave të votimit për shkak edhe ne si anëtarë jemi të obliguar që pra kemi të drejtën e votës dhe duhet ta shfrytëzojmë atë të drejtë në vendvotime në qytetet ku secili prej nesh e ka të drejtën e votimit...

Florian Dushi: Ne e kemi diskutuar në këshill dhe kishim mundësi si anëtar të këshillit të japim edhe propozimet tona, megjithatë meqë KQZ përfundimisht e vendos, aty diçka që e mendova ta propozoj më ka ikur dhe po e propozoj këtu në KQZ që thjeshtë, dhoma operative e cila do të funksionoj në ditën e zgjedhjeve në orët e hershme të mëngjesit në ditën e zgjedhjeve në çfarëdo kohë që mund ta planifikojë zëdhënësi, bashkë me ata që e udhëheqin këtë dhomë operative, thjeshtë ta hapim për disa minuta për media: le ta shohin se si funksionon kjo dhomë operative, kush është pjesë e kësaj dhome operative, mos të duket diçka, mos të mbetet kjo si njëfarë enigme...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka tjetër, e hedh në votim planin operacional me propozimin e z. Dushi. Kush është për miratimin e planit operacional, edhe me propozimin e z. Dushi?

Atëherë, në mënyrë unanime miratohet plani operacional për ditën e zgjedhjeve.

Arianit Elshani: Jemi te pika e cila u ngrit edhe nga z. Kurtoshi në fillim. KOZ, ka shqyrtuar rekomandimin e Sekretariatit për shënjimin dhe vulosjen e emrave të votuesve të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës dhe të cilët kanë ndërruar jetë pas certifikimit të listës përfundimtare të votuesve për zgjedhjet lokale 2021 dhe është pikërisht meqë janë shtypur tashmë edhe listat votuese dhe nuk kanë mundur që ky proces të prolongohet më shumë që ato të shtypen të shtunën apo të premten.

Këto lista të votuesve, do të vulosen secila që tu hiqet e drejta për të votuar në ato emra, në atë barkod, në atë hapësirë për t'u nënshkruar, pra emrat e të cilëve do të largohen do të jenë 27 personave të cilët kanë vdekur - kanë ndërruar jetë në ndërkohë nga 13 shtatori deri më tash, dhe të cilat janë lajmëruar në komunat e tyre, dhe 320 emra të tjerë të cilët janë verifikuar nga Agjensioni i Regjistrimit Civil që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës: kjo, pas datës 13 shtator të 2021. I keni edhe në formë tabelare para vetes, pra për secilën komunë se nga sa persona janë hequr të atyre që kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës dhe të atyre të cilët kanë ndërruar jetë në komunat përkatëse. Dhe që zyrtarët e lartë komunalë, obligohen pra që të bëjnë këtë verifikim dhe të vulosin gjithë ata emra dhe mbiemra dhe ne të informojmë ata lidhur me kodet e regjistrimit civil...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, atëherë e hedh në votim. Kush është për miratimin e këtij rekomandimi? Me vota unanime, miratohet rekomandimi për shënimin, vulosjen e emrave të votuesve të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia apo kanë ndërruar jetë pas certifikimit të listës përfundimtare të votuesve.

5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:

Fazli Stollaj: Këshilli për Mbikëqyrje të Informimit publik, me datën 12 ka shqyrtuar dhe ka miratuar dizajnin e qendrës mediale e cila, do të jetë e cila do të jetë salla që do të rregullohet si qendër mediale. Dizajni, do të jetë vazhdimësi e dizajnit që janë përdorur gjatë materialeve për informim të publikut gjatë këtij procesi zgjedhor, do të përfshihet logoja e KQZ-së, do të përfshihet logoja e zgjedhjeve lokale të 17 tetorit, si dhe slogani. Pra, ky ishte një informim i shkurtë dhe po besoj Këshilli për Informim Publik ka përmbyllë punën që ka të bëjë me këtë fazë të zgjedhjeve për zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Faleminderit.